ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA? REZULTATET NGA GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE 2016-2025

Shkolla e Mesme Profesionale “Kolin Gjoka”

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" S4J

"Aftësi për Punë" S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2016-2025) 10
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2025) 17
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2025) 18
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2025) 18
Tabela 5: Perceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2025) 25
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2025) 27
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2016-2025) 28
Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2016-2025) 28
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025) 31
Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2016-2025) 33
Tabela 11: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2020-2025) 34
Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2016-2025) 35
Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2025) 37
Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2025) 38

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025) 10
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025) 11
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2025) 11
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025) 12
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2025) 12
Figura 6: Punësimi kundrejt vetë-punësimit (2018-2025) 13
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025) 14
Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025) 14
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2025) 15
Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2020-2025) 16
Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2025) 17
Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025 19
Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2018-2025) 20
Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025) 21
Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2025) 22
Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2018-2025) 22
Figura 17: Madhësia e kompanisë (2016-2025) 23
Figura 18: Lloji i kontratës (2016-2025) 24
Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2025) 24
Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025) 26
Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025) 29

Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025) 29
Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2025) 30
Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2025) 31
Figura 25: Papunësia ndër vite (2016-2025) 32
Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2025) 32
Figura 27: Metodat e kërkimit për punë (2020-2025) 34
Figura 28: Të diplomuarit papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2016-2025) 35
Figura 29: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2025) 36
Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe shkollë sipas gjinisë 2025 38

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave 3
Lista e figurave 3
Gjetjet kryesore 6
Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve? 8
Të diplomuarit 2016-2025 10
Analiza e rezultateve 12
Statusi i punësimit 12
Lidhja e punës me fushën e arsimit 15
Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës 18
Niveli i pagave 19
Kushtet e punës 22
Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës 25
Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë 26
Mënyrat e gjetjes së punës së parë 27
Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme 29
Të diplomuarit pa punë 32
Propozimet për përmirësim në shkollë 35
Planet për të ardhmen 38

Gjetjet kryesore

Ky raport paraqet rezultatet kryesore nga gjurmimi i dhjetë brezave të të diplomuarve të shkollës "Kolin Gjoka" duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në vitin 2016.

- Në vitin 62% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar një vit pas diplomimit. Viti 2024 shënon një rritje të punësimit me 11 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2024 e cila ka qenë 51%.
- Ndërkohë 18% e të diplomuarve në vitin 2025, janë të papunë. Mesatarisht, për vitet 2016-2024, 27% e të diplomuarve kanë qenë të papunë një vit pas diplomimit. Si rezultat, për vitin 2025 kemi një ulje të papunësisë me 9 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024.
- Për të diplomuarit e vitit 2025, të diplomuarit në Teknologji Ushqimore kanë shkallën më të lartë të punësimit një vit pas diplomimit me 86%, ndjekur nga të diplomuarit në Ekonomi Biznes 79% , Hoteleri-Turizëm 78%, TIK me 58% dhe Shërbime Sociale dhe Shëndetësore me 25%. Ndërkohë shkallën më të lartë të papunësisë e kanë 31% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore , 16% e të diplomuarve në TIK, 14% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 14% e të diplomuarve në Teknologji Ushqimore dhe 11% e të diplomuarve në Hoteleri Turizëm. Të diplomuarit në degën e Shërbime Sociale dhe Shëndetsore janë ata të cilët vijojnë më shumë studime të mëtejshme. Përkatësisht, 44% e të diplomuarve në këtë degë janë student/kursant një vit pas diplomimit. Ndërkohë, 16% të diplomuar në TIK, dhe 6% e të diplomuar në Hoteleri-Turizëm.
- Vërehet se mesatarisht (2020-2025), 34% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 79% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 28% e të diplomuarve në TIK janë të punësuar në profesion. Gjithashtu mesatarisht 25% e të diplomuarve në Teknologji Ushqimore dhe 4% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore janë të punësuar në profesion. Si rezultat, të diplomuarit në Hoteleri-Turizëm pohojnë një lidhje më të madhe të punës me arsimin në raport me drejtimet e tjera të ofruara nga shkolla.
- 60% e të gjurmuarve pohojnë se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë "shumë" dhe "jashtëzakonisht shumë", duke shënuar një rritje me 15 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (45%).
- Për sa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2025 shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 9% deri në 50,000 lekë, 28% në fashën 50, 001 – 60, 000 lekë, 7% në fashën 60, 001 – 80, 000 lekë dhe 18% paguhen në fashën 80,001- 95,000 lekë, 21% në fashën 95,001 lekë – 120,000 lekë dhe 16% me më shumë se 120,001 lekë.
- Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve vëmë re se vetëm 7% e të diplomuarve në Hoteleri- Turizëm, 20% e të diplomuarve në TIK, 22% e të diplomuarve në Ekonomi dhe Biznes dhe 33% e të diplomuarve në Teknologji Ushqimore marrin një pagë deri në 50,000 lekë. Ndërkohë, 25% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, dhe 14% e të diplomuarve në Hoteleri – Turizëm marrin një pagë 50,001 – 60,000 lekë. Ndërkohë, një pagë 60,001 – 80,000 lekë e marrin përkatësisht 22% e të diplomuarve në Ekonomi Biznes, 7% e të

diplomuarve në Hoteleri- Turizëm, 33% e të diplomuarve në Teknologji Ushqimore, 20% e të diplomuarve në TIK dhe 50% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore. Për më tepër, 14% e të diplomuarve në Hoteleri Turizëm dhe 10% e të diplomuarve në TIK marrin një pagë 80,001- 95,000 lekë. Gjithashtu, 11% e të diplomuarve në Ekonomi Biznes, 43% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 10% e të diplomuarve në TIK marrin një pagë 95,001-120,000 lekë.


- Ndërsa, 33% e të diplomuarve në Teknologji Ushqimore, 30% e të diplomuarve në TIK si, 25% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, 22% e të diplomuarve në Ekonomi Biznes dhe 7% e të diplomuarve në Hoteleri Turizëm më shumë se 120,001 lekë pagë.
- 58% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punën para diplomimit, me një rritje prej 9 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (49%).
- Për të dhjetë brezat e gjurmuar lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre janë forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë. Mesatarisht, 66% e të diplomuarve gjatë viteve 2016-2024, kanë gjetur punë nëpërmjet lidhjeve personale. Për të diplomuarit e vitit 2025 kjo përqindje është 58%, duke shënuar një ulje me 8 pikë përqindje. Ndërkohë, 74% e të diplomuarve në vitin 2025, ndjehen "të sigurt" ose "shumë të sigurt" në vendin e punës, me një rritje prej 1 pikë përqindje nga mesatarja 2016-2024 (73%). Ndërkohë, vetëm 2% e të diplomuarve të gjurmuar janë shprehur se ndjehen "shumë të pasigurt", me një rëniee prej 6 pikë përqindje nga mesatarja 2016-2024 (8%).
- Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2025, të gjurmuarit vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim "shumë/jashtëzakonisht shumë". Përkatësisht, nevoja për përmirësimin e bashkëpunimit me bizneset (33%), me një rënie me 18 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2024 (51%), këshillimi i karrierës (33%), me një rënje me 10 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2024 (43%) bashkëpunimi me zyrat e punës (29%), me një rënie me 18 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (47%), si bashkëpunimi me zyrat e punës (29%).
- Brenda dy viteve të ardhshme, 43% e të diplomuarve në vitin 2025 pohojnë se kanë dëshirë të kenë gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit. Aspiratat për një gjë të tillë kanë shënuar rritje për vitin 2025 kanë shënuar një rritje me13% pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2024 (30%). Për më tepër, 31% duan të kenë filluar biznesin e tyre, me një rritje prej 2 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (29%) si dhe 19% e të diplomuarve kanë dëshirë të jenë duke ndjekur studime të mëtejshme, duke ruajtur të njëjtën përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (19%). Ndërkohë, për vitin 2025, vetëm 7% e të diplomuarve planifikojnë të emigrojnë jashtë vendit në dy vitet e ardhshme, me një ulje me 9 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2024 (16%). Dëshira për migrim të brendshëm gjithashtu është ulur në 1%.

Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' **të diplomuarit** pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, shkolla **"Kolin Gjoka"**, me mbështetjen e projektit 'Aftësi për Punë' (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

a. Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
b. Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësori të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësori të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit ‘Aftësi për Punë’.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **dhjetë brezave me të diplomuar** të shkollës “Kolin Gjoka”.

Të diplomuarit 2016-2025


Në vitin shkollor 2024-2025, në shkollën “Kolin Gjoka” u diplomuan 74 nxënës (shiko tabelën 1).

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2016-2025)

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2015-2016	119	64	54%
2016-2017	80	66	83%
2017-2018	70	46	66%
2018-2019	62	55	89%
2019-2020	113	96	85%
2020-2021	118	116	98%
2021-2022	110	107	97%
2022-2023	80	78	98%
2023-2024	75	74	99%
2024-2025	**74**	**74**	**100%**

Nga të diplomuarit e vitit 2024-2025 u gjurmuan 74 nxënës ose 100% e të diplomuarve. Nga këta, 42 ishin djem (57%) dhe 32 (43%) ishin vajza (shiko figurën 1).


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza** (N=74)

Shpërndarja e të gjurmuarve sipas drejtimeve jepet në figurën 2. Përkatësisht, 24% e të gjurmuarve i përkasin drejtimit Hoteleri-Turizëm, 26% TIK, 22% Shërbime Sociale, 19% Ekonomi- Biznes dhe 10% Teknologji Ushqimore.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=74

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 92% e të diplomuarve të gjurmuar janë përgjigjur se jetojnë në Shqipëri, dhe 8% jashtë vendit (shiko figurën 3). Mesatarisht për vitet 2020-2025, 84% e të diplomuarve jetojnë në Shqipëri dhe 12% jetojnë jashtë vendit një vit pas diplomimit.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=96); **2021** (N=116); **2022** (N=107); **2023** (N=78), **2024** (N=74), **2025** (N=74).

Analiza e rezultateve

Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2023-2025), nga një total prej 74 të anketuarish 53% (N=39) ishin të punësuar, 4% (N=3) ishin të vetëpunësuar, 15% (N=11) ishin student/kursant, 5% (N=4) ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë. Ndërkohë, të papunë ishin 18% (N=13) të diplomuar një vit pas diplomimit.

Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=74

Referuar figurës 5, në vitin 2025, 62% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar një vit pas diplomimit. Viti 2024 shënon një rritje të punësimit me 11 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2024 e cila ka qenë 51%.

Ndërkohë, 18% e të diplomuarve në vitin 2025, janë të papunë. Mesatarisht, për vitet 2016-2024, 27% e të diplomuarve kanë qenë të papunë një vit pas diplomimit. Si rezultat, për vitin 2025 kemi një ulje të papunësisë me 9 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024.

Ndërkohë, 15% e të diplomuarve të vitit 2025 janë student/kursant. Mesatarisht, në vitet 2016-2024 21% e të diplomuarve kanë qenë student/kursant. Pra, kemi një ulje me 6 pikë përqindje të atyre që vijojnë studimet e mëtejshme për vitin 2025 në raport me mesataren e viteve 2016-2024.


Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=64); **2017** (N=66); **2018** (N=46); **2019** (N=55); **2020** (N=96); **2021** (N=116); **2022** (N=107); **2023** (N=78), **2024 (**N=74), **2025 (**N=74)

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Për vitin 2025, 53% e të diplomuarve janë të punësuar dhe 4% të vetëpunësuar (shiko figurën 6). Vërehet një rritje me 15 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (38%) e punësimit në raport me vetëpunësimin. Ndërkohë, mesatarja e vetëpunësimit ne vitet 2016-2024 ka qenë 8%. Si rezultat, kemi një rënie të vetëpunësimit me 4 pikë përqindje për vitin 2025.

Figura 6: Punësimi kundrejt vetë-punësimit (2018-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016**: (N=64); **2017**: (N=66); **2018**: (N=46); **2019**: (N=55); **2020**: (N=96); **2021**: (N=116); **2022**: (N=107); **2023** (N=78), **2024** (N=74), **2025** (N=74)

Në figurën 7, jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve të ofruara nga shkolla. Sikurse vihet re, Për të diplomuarit e vitit 2025, të diplomuarit në Teknologji Ushqimore kanë shkallën më të lartë të punësimit një vit pas diplomimit me 86%, ndjekur nga të diplomuarit në Ekonomi Biznes 79% , Hoteleri-Turizëm 78%, TIK me 58% dhe Shërbime Sociale dhe Shëndetësore me 25%.

Ndërkohë, 31% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore , 16% e të diplomuarve në TIK, 14% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 14% (N=1) e të diplomuarve në Teknologji Ushqimore dhe 11% e të diplomuarve në Hoteleri Turizëm janë të papunë një vit pas diplomimit.

Sikurse e tregon edhe figura 7, të diplomuarit në degën e Shërbime Sociale dhe Shëndetsore janë ata të cilët vijojnë më shumë studime të mëtejshme. Përkatësisht, 44% e të diplomuarve në këtë degë janë student/kursant një vit pas diplomimit. Ndërkohë, 16% të diplomuar në TIK, dhe 6% e të diplomuar në Hoteleri-Turizëm.


Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: EB** (N=14); **HT** (N=18); **TIK** (N=19); **SHSSH** (N=16); **TU** (N=7)

Të ndara sipas gjinisë (shih figurën 8), të dhënat tregojnë se 53% e vajzave dhe 69% e djemve janë të punësuar një vit pas diplomimit. Pa punë janë 25% e vajzave dhe 12% e djemve. Ndërkohë, studime të mëtejshme ndjekin 19% e vajzave dhe vetë 12% e djemve.

Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: M** (N=42); **F** (N=32).

Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 39% e të diplomuarve u shprehën se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit, ndërsa 61% u shprehën që nuk lidhet. Nga viti 2016 deri në 2024 (shiko figurën 9), mesatarisht 43% e të diplomuarve pohuan se puna lidhet me fushën e tyre të arsimit dhe 57% se puna nuk lidhet me fushën e tyre të arsimit. Si rezultat, për vitin 2025 vërehet një rënie me 4 pikë përqindje e të diplomuarve që pohojnë se puna lidhet me fushën e arsimit në krahasim me mesataren e viteve 2016-2024.


Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=20); **2017** (N=23); **2018** (N=18); **2019** (N=16); **2020** (N=56); **2021** (N=76); **2022** (N=69); **2023** (N=44), **2024** (N=47), **2025** (N=44)

Nëse analizojmë lidhjen e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (shiko figurën 10), vërehet se mesatarisht (2020-2025), 34% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 79% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 28% e të diplomuarve në TIK janë të punësuar në profesion. Gjithashtu mesatarisht 25% e të diplomuarve në Teknologji Ushqimore dhe 4% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore janë të punësuar në profesion. Si rezultat, të diplomuarit në Hoteleri-Turizëm pohojnë një lidhje më të madhe të punës me arsimin në raport me drejtimet e tjera të ofruara nga shkolla.


Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2020**: N_{EB}=15; N_{HT}=23; N_{TIK}=18; **Baza 2021**: N_{EB}=17; N_{HT}=30; N_{TIK}=24; N_{SHSSH}=5; **Baza 2022:** N_{EB}=9; N_{HT}=37; N_{TIK}=20; N_{SHSSH}=3; **Baza 2023:** N_{EB}=8; N_{HT}=13; N_{TIK}=9; N_{SHSSH}=5; N_{TU}=9, **Baza 2024:** N_{EB}=7; N_{HT}=17; N_{TIK}=5; N_{SHSSH}=9; N_{TU}=9, **Baza 2025:** N_{EB}=9; N_{HT}=14; N_{TIK}=11; N_{SHSSH}=9; N_{TU}=4

Të ndara sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se 41% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 59% e të diplomuarave të gjinisë femërore janë të punësuara në një punë që lidhet me fushën e tyre të arsimit.

Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: M** (N=27); **F** (N=16)

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), vërehet se të diplomuarit e brezit 2024-2025 japin vetëm një arsye kryesore: (i) pamundësia për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet (100% në 2025, mesatarja 2018-2024, 25%)

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2025)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	70%	45%	27%	44%	38%	50%	62%	**100%**
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	0%	0%	9%	16%	28%	10%	4%	**0%**
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	10%	18%	5%	7%	3%	5%	12%	**0%**
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	10%	27%	50%	28%	28%	25%	23%	**0%**
Tjetër	10%	9%	9%	5%	3%	10%	0%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=10); **2019** (N=11); **2020** (N=22); **2021** (N=43); **2022** (N=29); **2023** (N=20), **2024** (N=26), **2025** (N=43)

Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në 2025 tregojnë se njohuritë përdoren "shumë/jashtëzakonisht shumë" nga 60% e të gjurmuarve. Mesatarisht, 45% e të diplomuarve në vitet 2016-2025 kanë pohuar se i përdorin "shumë/jashtëzakonisht shumë" njohuritë e fituara në shkollë. Si rezultat, për vitin 2024 vërehet një rritje me 15 pikë përqindje e të diplomuarve që pohojnë se i përdorin "shumë/jashtëzakonisht shumë" njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë në vendin e punës.

Ndërkohë, 13% e të diplomuarve janë përgjigjur se i përdorin "aspak" njohuritë e fituara gjatë studimeve. Mesatarja për këtë kategori për vitet 2016-2024 ka qenë 12%. Pra, kemi ndër vite një rënie me 1 pikë përqindje të numrit të të diplomuarve të cilët pohojnë se i përdorin "aspak" njohuritë e fituara në shkollë në vendin e punës. Ndërsa kategoria e atyre që janë përgjigjur se i përdorin "disi" për vitin 2025 është 22%. Mesatarja për këtë kategori për vitet 2016-2024 ka qenë 28%.

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2025)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2016	15%	35%	5%	25%	20%
2017	12%	30%	27%	24%	6%
2018	13%	25%	25%	6%	31%
2019	10%	14%	38%	24%	14%
2020	21%	18%	9%	32%	20%
2021	12%	34%	21%	13%	20%
2022	10%	10%	28%	20%	32%
2023	6%	15%	29%	29%	21%
2024	10%	14%	17%	21%	39%
2025	**13%**	**9%**	**28%**	**22%**	**28%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016 (**N=20); **2017 (**N=33); **2018 (**N=16); **2019** (N=21); **2020** (N=56); **2021** (N=76); **2022** (N=69); **2023** (N=52), **2024** (N=52), **2025** (N=52)

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 54% e të diplomuarve në vitin 2025 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me "shumë/jashtëzakonisht shumë". Nga ana tjetër, 31% e vlerësojnë me "pak/aspak" lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimit. Mesatarisht, 35% e të diplomuarve në vitet 2016-2024 e vlerësojnë lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve "shumë/jashtëzakonisht shumë" dhe 31% me "aspak".

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2025)


	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2016	45%	10%	10%	20%	15%
2017	24%	42%	15%	12%	6%
2018	38%	25%	13%	19%	6%
2019	24%	19%	33%	10%	14%
2020	43%	7%	13%	21%	16%
2021	45%	12%	12%	17%	14%
2022	25%	10%	19%	25%	22%
2023	17%	13%	31%	24%	15%
2024	17%	14%	10%	21%	39%
2025	**26%**	**7%**	**13%**	**17%**	**37%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=20); **2017** (N=33); **2018** (N=16); **2019** (N=21); **2020** (N=56); **2021** (N=76); **2022** (N=69); **2023** (N=54), **2024** (N=52), **2025** (N=54)

Niveli i pagave

Në 2025. për shkak të ndryshimit të pagesës minimale (nga 40,000 lekë në 50,000 lekë) nga 1 janar 2025, janë rishikuar kategoritë e pagave ne pyetësor. Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2025 (shiko figurën 12), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 9% deri në 50,000 lekë, 28% në fashën 50, 001 – 60, 000 lekë, 7% në fashën 60, 001 – 80, 000 lekë dhe 18% paguhen në fashën 80,001- 95,000 lekë, 21% në fashën 95,001 lekë – 120,000 lekë dhe 16% me më shumë se 120,001 lekë.

Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=43

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko figurën 13), pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve. Për vitin 2025, 15% e të diplomuarve të gjurmuar merr një pagë më të ulët se paga minimale 50,000 lekë.

Ndërkohë, është rritur me 1 pikë përqindje numri i të diplomuarve që marrin një pagë 50,001 – 65,000 lekë (11% mesatarja 2016-2024, 10% në 2025). Gjithashtu, është rritur me 12 pikë përqindje numri i të diplomuarve që marrin një pagë 65,001 – 80,000 lekë (14% mesatarja 2016-2024, 26% në 2025).

Viti 2025, shënon edhe përqindje të lartë të të diplomuarve që marrin një pagë më shumë se 80,001 lekë. Kështu, 48% e të diplomuarve në vitin 2025 marrin një pagë më të lartë se 80,001 lekë, ndërkohë mesatarisht nga viti 2016-2024, vetëm 17% e të diplomuarve të gjurmuar e kanë marrë këtë pagë. Në këtë aspekt viti 2024 shënon një rritje me 31 pikë përqindje të atyre që marrin më shumë se 80,001 lekë.

Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2018-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016 (**N=20); **2017 (**N=23); **2018 (**N=16); **2019** (N=16); **2020** (N=56); **2021** (N=76); **2022** (N=69); **2023** (N=45), **2024** (N=47), **2025** (N=74).

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 14), vëmë re se vetëm 7% e të diplomuarve në Hoteleri- Turizëm, 20% e të diplomuarve në TIK, 22% e të diplomuarve në Ekonomi dhe Biznes dhe 33% e të diplomuarve në Teknologji Ushqimore marrin një pagë deri në 50,000 lekë. Ndërkohë, 25% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, dhe 14% e të diplomuarve në Hoteleri – Turizëm marrin një pagë 50,001 – 60,000 lekë. Ndërkohë, një pagë 60,001 – 80,000 lekë e marrin përkatësisht 22% e të diplomuarve në Ekonomi Biznes, 7% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 33% e të diplomuarve në Teknologji Ushqimore, 20% e të diplomuarve në TIK dhe 50% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore. Për më tepër, 14% e të diplomuarve në

Hoteleri Turizëm dhe 10% e të diplomuarve në TIK marrin një pagë 80,001- 95,000 lekë. Gjithashtu, 11% e të diplomuarve në Ekonomi Biznes, 43% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 10% e të diplomuarve në TIK marrin një pagë 95,001- 120,000 lekë.

Ndërsa, 33% e të diplomuarve në Teknologji Ushqimore, 30% e të diplomuarve në TIK si, 25% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, 22% e të diplomuarve në Ekonomi Biznes dhe 7% e të diplomuarve në Hoteleri Turizëm më shumë se 120,001 lekë pagë.


Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N_{EB}=9; N_{HT}=14; N_{TU}= 6; N_{TIK}=10; N_{SHSSH}=4

Nga të dhënat e disagreguara sipas gjinisë (figura 15), të dhënat tregojnë se të diplomuarit meshkuj kanë tendencë të fitojnë paga më të larta se femrat. Pjesa më e madhe e meshkujve 67% marrin mbi 80,001 Lekë, ndërsa te femrat vetëm 12% fitojnë mbi këtë nivel. Nga ana tjetër, femrat janë më të përqendruara në pagat e ulëta deri në 50,000 Lekë (25% krahasuar me 11% te meshkujt). Kjo tregon një hendek të qartë gjinor në pagat e të diplomuarve.

Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=43

Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), për të tetë brezat e gjurmuar vërehet që mbizotëron punësimi me kohë të plotë. Mesatarisht 81% e të diplomuarve (2016-2025) punojnë me kohë të plotë një vit pas diplomimit. Ndërkohë, mesatarisht 8% e të diplomuarve (2016-2025) punojnë me kohë të pjesshme dhe 11% me kohë të plotë sezonale.

Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2018-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016 (**N=14); **2017 (**N=16); **2018 (**N=14); **2019** (N=16); **2020** (N=40); **2021** (N=69); **2022** (N=66); **2023** (N=44),); **2024** (N=47), **2025** (N=43)

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 17), në brezin e fundit të të gjurmuarve (2025) vërehet se 19% e të diplomuarve punojnë në kompani me 1-4 punonjës, 33% në kompani me 5-9 punonjës dhe 26% në kompani me 10-49 punonjës., ndërsa vetëm 23% e tyre në kompani mbi 50 punonjës.

Mesatarisht, nga viti 2016-2025, 22% e të diplomuarve kanë punuar në kompani me më shumë se 50 punonjës, 25% në kompani me 10-49 punonjës, 30% në kompani me 5-9 punonjës dhe 23% në kompani me 1-4 punonjës.


Figura 17: Madhësia e kompanisë (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016 (**N=9); **2017 (**N=16); **2018 (**N=14); **2019** (N=16); **2020** (N=40); **2021** (N=69); **2022** (N=66); **2023** (N=44), **2024** (N=47), **2025** (N=43).

Në vitin 2025, 77% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 18). Nga ku, 40% kanë një kontratë pune me afat të caktuar dhe 37% me afat të pacaktuar. Ndërkohë, 23% nuk kanë një kontratë pune. Numri i këtyre të fundit mbetet i lartë. Për vitin 2025 vërehet një rënie me 4 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 ku 27% e të diplomuarve nuk kishin një kontratë pune me punëdhënësin.


Figura 18: Lloji i kontratës (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016 (**N=14); **2017 (**N=16); **2018 (**N=14); **2019** (N=16); **2020** (N=40); **2021** (N=69); **2022** (N=66); **2023** (N=44), **2024** (N=47), **2025** (N=43).

Sipas rezultateve të gjurmimit të të nëntë brezave, 79% e të diplomuarve të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 19). Ndërkohë, mesatarisht 14% deklarojnë se nuk iu paguhen sigurimet nga punëdhënësi dhe 7% shprehen se nuk kanë informacion nëse iu paguhen apo jo sigurimet.

Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016 (**N=14); **2017 (**N=16); **2018 (**N=13); **2019** (N=16); **2020** (N=40); **2021** (N=69); **2022** (N=66); **2023** (N=44), **2024** (N=47), **2025** (N=43)

Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 74% e të diplomuarve në vitin 2025, u shprehën se ndjehen "të sigurt ose shumë të sigurt" (shiko tabelën 5). Këtu vërehet një rritje me 1 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (73%). Ndërkohë, vetëm 2% e të diplomuarve të gjurmuar janë shprehur se ndjehen "shumë të pasigurt". Mesatarisht, nga viti 2016 në vitin 2024, 8% e të diplomuarve kanë pohuar se ndjeheshin "shumë të pasigurt". Pra, vërehet një rënie e pasigurisë me 6 pikë përqindje.

Të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 74% e të diplomuarve në vitin 2025 shprehen se ndjehen "të kënaqur ose shumë të kënaqur" dhe asnjë nuk u shprehen "shumë të pakënaqur".

Tabela 5: Perceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Siguria										
Shumë i/e pasigurt	7%	0%	0%	13%	5%	3%	8%	16%	21%	**2%**
I/e pasigurt	0%	6%	0%	19%	3%	4%	3%	5%	13%	**2%**
Neutral	0%	19%	15%	0%	20%	13%	17%	23%	13%	**14%**
I/e sigurt	79%	69%	77%	63%	23%	64%	44%	25%	19%	**42%**
Shumë i/e sigurt	14%	6%	8%	6%	50%	16%	29%	32%	34%	**40%**
Kënaqësia										


Shumë i/e pakënaqur	7%	13%	8%	13%	3%	4%	6%	7%	23%	**0%**
I/e pakënaqur	0%	6%	8%	6%	5%	3%	6%	7%	4%	**7%**
Neutral	0%	25%	8%	13%	15%	16%	11%	11%	11%	**19%**
I/e kënaqur	57%	38%	62%	50%	43%	61%	48%	36%	30%	**30%**
Shumë i/e kënaqur	36%	19%	15%	19%	35%	16%	29%	39%	31%	**44%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016 (**N=14); **2017 (**N=16); **2018 (**N=13); **2019** (N=16); **2020** (N=40); **2021** (N=69); **2022** (N=66); **2023** (N=44), **2024** (N=47), **2025** (N=43).

Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 58% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën se kanë arritur ta gjejnë punën para diplomimit, 7% janë punësuar 1 muaj pas diplomimit, 5% janë punësuar 1 – 3 muaj pas diplomimit, 16% janë punësuar 3 – 6 muaj pas diplomimit dhe 9% kanë gjetur punë 6 – 9 muaj pas diplomimit. Ndërkohë, 5% e të diplomuarve kanë arritur të gjejnë punë 9 - 12 muaj pas diplomimit.

Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=43.

Në një vështrim krahasues me vitet e mëparshme (shiko tabelën 6), mesatarisht 49% e të diplomuarve 2016-2024 kanë arritur të gjejnë punë para diplomimit. Në këtë aspekt kemi një rritje me 9 pikë përqindje për vitin 2025, ku 58% e të diplomuarve arritën të gjejnë një punë para diplomimit. Ndërkohë, mesatarisht 12% e të diplomuarve arrijnë të gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit (2016-2024). Në këtë kategori kemi një rënie me 5 pikë përqindje për vitin 2025 ku 7% e të diplomuarve gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit.

Ndërkohë, është ulur me 2 pikë përqindje numri i të diplomuarve që gjejnë punë 9 - 12 muaj pas diplomimit (5% në 2025, përkundrejt 7% mesatarja në vitet 2016-2024). Për të dhjetin vit radhazi nuk ka të diplomuar të cilët gjejnë punë më shumë se një vit pas diplomimit.

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Para diplomimit	31%	38%	38%	33%	61%	55%	51%	61%	66%	**58%**
1 muaj pas diplomimit	44%	4%	13%	19%	8%	10%	8%	9%	11%	**7%**
1 - 3 muaj pas diplomimit	6%	27%	31%	14%	18%	5%	13%	11%	6%	**5%**
3 - 6 muaj pas diplomimit	0%	15%	6%	19%	6%	13%	8%	11%	9%	**16%**
6 - 9 muaj pas diplomimit	0%	8%	0%	10%	2%	9%	11%	5%	2%	**9%**
9 - 12 muaj pas diplomimit	13%	8%	13%	5%	4%	8%	8%	2%	6%	**5%**
Më shumë se 1 vit pas diplomimit	6%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016 (**N=16); **2017 (**N=26); **2018 (**N=16); **2019** (N=21); **2020** (N=49); **2021** (N=77); **2022** (N=72); **2023** (N=44), **2024** (N=47), **2025** (N=43)

Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, vërehet se për të dhjetëtë brezat e gjurmuar lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre janë forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë. Mesatarisht, 66% e të diplomuarve gjatë viteve 2016-2024, kanë gjetur punë nëpërmjet lidhjeve personale. Për të diplomuarit e vitit 2025 kjo përqindje është 58%, duke shënuar një ulje me 8 pikë përqindje.

Për më tepër, 10% e të diplomuarve gjatë viteve 2016-2024 kanë gjetur punë duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësit, kjo situatë ka ndryshim gjatë vitit 2025 pasi ka shënuar ulje me 3 pikë përqindje. Ndërkohë, 10% kanë gjetur punë nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale dhe gazeta. Mesatarisht, gjatë viteve 2016-2024, 10% e të diplomuarve e kanë gjetur punën e parë falë njoftimeve për punë. Këtu vërehet një rritje me 6 pikë përqindje për vitin 2025, ku 16% e të diplomuarve e gjetën punën falë njoftimeve.

Për më tepër, 14% e kanë gjetur punën përmes praktika profesionale në biznes. Mesatarisht, 11% e të diplomuarve gjatë viteve 2016-2024 e kanë gjetur punën e parë falë praktikës profesionale në biznes. Vërehet një rritje me 3 pikë përqindje në këtë kategori për vitin 2025, ku 14% e të diplomuarve janë shprehur se e kanë gjetur punën e parë falë praktikës profesionale në biznes.

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	**2023**	**2024**	**2025**
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	0%	13%	7%	19%	10%	6%	18%	9%	11%	**16%**
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	79%	63%	86%	63%	58%	62%	56%	64%	65%	**58%**
Nga praktika profesionale në biznes	14%	0%	0%	6%	15%	19%	20%	9%	17%	**14%**
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	7%	25%	7%	13%	13%	6%	5%	11%	4%	**7%**
Nga mësuesit	0%	0%	0%	0%	0%	3%	0%	0%	0%	**0%**
Nga Zyra e Punësimit	0%	0%	0%	0%	3%	1%	0%	0%	0%	**0%**
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	0%	0%	0%	0%	3%	1%	2%	5%	0%	**5%**
Tjetër	0%	0%	0%	0%	0%	1%	0%	2%	0%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016 (**N=16); **2017 (**N=26); **2018 (**N=16); **2019** (N=21); **2020** (N=49); **2021** (N=77); **2022** (N=72); **2023** (N=44), **2024** (N=46), **2025** (N=43).

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 8), në vitin 2025, 70% pohuan se shkolla i ka mësuar se si të aplikojnë për punë (rritje me 42 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024, 38%); 48% pohuan se i ka ndihmuar në orientimin mbi mundësitë e ndryshme për punësim (rritje me 6 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024, 42%), dhe 35% pohuan që shkolla i ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë, me një rritje prej 13 pikë përqindje nga mesatarja 2026-2024 (22%) Gjithashtu, vërehet një rënie e numrit të atyre që pohojnë se përgjithësisht shkolla nuk i ka ndihmuar. Në vitin 2025, 13% e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se shkolla përgjithësisht nuk i ka ndihmuar. Në këtë aspekt kemi një rënie me 3 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (16%).

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2016-2025)


	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	**2023**	**2024**	2025
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	10%	36%	38%	52%	25%	38%	49%	44%	48%	**70%**
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	20%	58%	38%	29%	36%	47%	43%	44%	62%	**48%**
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	45%	9%	13%	14%	16%	24%	23%	23%	29%	**35%**
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	10%	0%	13%	19%	32%	14%	23%	19%	12%	**13%**
Tjetër	20%	6%	6%	0%	0%	4%	1%	6%	0%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016 (**N=20); **2017; (**N=33); **2018 (**N=16); **2019** (N=21); **2020** (N=56); **2021** (N=76); **2022** (N=69); **2023** (N=52), **2024** (N=52), **2025** (N=43)

Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Për vitin 2025, vetëm 5% e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se janë të punësuar por edhe studiojnë në të njëjtën kohë. Kjo mesatare për vitet 2016-2024 ka qenë po 5%. Ndërkohë, 15% e të diplomuarve të gjurmuar për vitin 2025 shprehen se janë student/kursant. Këtu vërehet një ulje me 6 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 e cila ka qenë 21%.


Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016 (**N=64); **2017 (**N=66); **2018 (**N=46); **2019** (N=55); **2020** (N=96); **2021** (N=116); **2022** (N=107); **2023** (N=78),); **2024** (N=74), **2025** (N=11).

Sikurse në vitet paraardhëse, pjesa më e madhe e të diplomuarve në vitin 2025 që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin 91%.


Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016 (**N=17); **2017 (**N=13); **2018 (**N=17); **2019** (N=17); **2020** (N=26); **2021** (N=18); **2022** (N=34); **2023** (N=12), **2024** (N=17), **2025** (N=11)

Nga të diplomuarit që ndjekin studime të mëtejshme, 91% studiojnë në institucione publike 9% në ato private. Sikurse duket edhe në figurën 23, viti 2025 shënon një rritje të numrit të nxënësve të cilët ndjekin institucionet publike. Nëse përgjatë viteve 2020-2024 ishin institucionet publike ato që përzgjidhnin të diplomuarit për të vijuar studimet e mëtejshme (62%) për vitin 2025 janë 91% e të diplomuarve të cilët e përzgjedhin duke shënuar në këtë mënyrë një rritje shumë të madhe me 31 pikë përqindje. Ndërkohë, është ulur me 29 pikë përqindje numri i të diplomuarve të cilët vijojnë studimet e mëtejshme në institucione private (9% për vitin 2025, 38% mesatarja 2020-2024).


Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016 (**N=17); **2017 (**N=13); **2018 (**N=17); **2019** (N=17); **2020** (N=26); **2021** (N=18); **2022** (N=34); **2023** (N=12), **2024** (N=17) , **2025** (N=11).

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet/trajnimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 24), 73% e të gjurmuarve që studiojnë janë shprehur se fusha e studimeve që po ndjekin a lidhet me shkollën që kanë bërë. Nga viti 2020 deri në 2025 mesatarisht 71% e të gjurmuarve u shprehën se studimet/trajnimet që ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë, përkundrejt 29% të cilët pohojnë se nuk lidhen.

Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=26); **2021** (N=18); **2022** (N=34); **2023** (N=12); **2024** (N=17), **2025** (N=11_)

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), 91% e të diplomuarve në 2025 janë përgjigjur për të fituar një kualifikim më të lartë (47% mesatarja e viteve 2016-2024), 9% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale (15% mesatarja e viteve 2016-2024), 0% për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë (35% mesatarja e viteve 2016-2024) dhe 0% pasi nuk po gjenin dot punë(3% mesatarja 2016-2024). .

Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025)


	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Për të fituar një kualifikim më të lartë	47%	38%	47%	40%	50%	33%	62%	67%	41%	**91%**
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	47%	46%	41%	47%	23%	50%	15%	17%	29%	**0%**
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	6%	8%	6%	13%	27%	17%	21%	8%	29%	**9%**
Nuk po gjeja dot punë	0%	8%	6%	0%	0%	0%	3%	8%	0%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=17); **2017** (N=13); **2018** (N=17); **2019** (N=15); **2020** (N=26); **2021** (N=18); **2022** (N=34); **2023** (N=12), **2024** (N=17), **2025** (N=11)

Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit për vitin 2024 është 18% (N=13), me një ulje me 11 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (27%).


Figura 25: Papunësia ndër vite (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=64); **2017** (N=66); **2018** (N=46); **2019** (N=55); **2020** (N=96); **2021** (N=116); **2022** (N=107); **2023** (N=78),); **2024** (N=74), **2025** (N=74)

Të pyetur nëse po kërkonin punë, 69% e të diplomuarve të papunë të vitit 2025 u përgjigjën që po kërkonin punë. E shprehur në numër absolut, 9 nga 13 të diplomuarit e papunë janë në kërkim të një pune. Ndërkohë 31% ose 4 nga 13 të diplomuarit e papunë nuk janë në kërkim të një pune. Sikundër tregohet edhe në figurën 26, viti 2025 shënon një përqindje të lartë të të diplomuarve të papunë të cilët janë në kërkim të një pune.

Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=27); **2021** (N=28); **2022** (N=16); **2023** (N=13), **2024** (N=7)), **2025** (N=13)

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko tabelën 10), nxjerr në pah se arsyet më madhore që mendohet se sjellin pamundësinë për të gjetur një punë janë: mungesa e ofertave për punë që lidhen me arsimimin (50% në 2025, 27% mesatarja e viteve 2016-2024), angazhimi në punë familjare (25% në 2025) dhe mungesa e punës në qarkun e tyre (25% në 2025)


Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Më mungon eksperienca e punës	12%	17%	27%	4%	18%	6%	13%	33%	0%	**0%**
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	4%	7%	0%	0%	0%	0%	13%	0%	0%	**0%**
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	4%	14%	18%	13%	12%	31%	38%	67%	50%	**50%**
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	31%	10%	18%	8%	18%	19%	13%	0%	0%	**0%**
Nuk ka punë në qarkun tim	27%	31%	18%	21%	35%	6%	13%	0%	0%	**25%**
Jam i/e angazhuar në punë familjare	0%	14%	18%	8%	0%	0%	13%	0%	50%	**25%**
Tjetër	15%	7%	0%	13%	12%	38%	0%	0%	0	**0%**
Nuk kam burime të mjaftueshme për t'u vetë-punësuar	8%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**
Nuk di si të kërkoj për punë	0%	0%	0%	0%	6%	0%	0%	0%	0%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=26); **2017** (N=29); **2018** (N=11); **2019** (N=24); **2020** (N=17); **2021** (N=16); **2022** (N=8); **2023** (N=3), **2024** (N=2), **2025** (N=4)

Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend pune (shiko figurën 27), për vitin 2025 të gjithë të diplomuarit e papunë që janë në kërkim të një pune po e kërkojnë atë nëpërmjet njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë, nëpërmjet shkollës, nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve etj.

Figura 27: Metodat e kërkimit për punë (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=17); **2021** (N=16); **2022** (N=8); **2023** (N=3), **2024** (N=2), **2025** (N=4).

Të pyetur për arsyet e mos kërkimit për punë (shiko tabelën 11), gjysma e të diplomuarve të papunë (50%) në vitin 2025 u shprehën se nuk kishin dëshirë të punonin për momentin. Ndërkohë, (25%) të diplomuar u shprehen se po kujdesen për fëmijët/familjarët dhe (25%) janë me aftësi ndryshe.


Tabela 11: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2020-2025)

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Po pres të filloj punë së shpejti	10%	17%	13%	20%	0%	**0%**
Nuk kam besim se do gjej një punë	0%	0%	13%	0%	0%	**0%**
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	30%	42%	38%	50%	80%	**50%**
Kam në plan të largohem nga vendi	30%	17%	13%	10%	0%	**0%**
Kujdesem për fëmijët/familjen	20%	8%	25%	10%	2%	**25%**
Jam me aftësi ndryshe	10%	0%	0%	10%	0%	**25%**
Tjetër	0%	17%	0%	0%	0%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=10); **2021** (N=12); **2022** (N=8); **2023** (N=10), **2024** (N=5), **2025** (N=4)

Për vitin 2025, 23% e të diplomuarve të papunë kanë pohuar se kanë qenë në një marrëdhënie pune më parë. Mesatarisht, gjatë viteve 2016-2024, 26% e të diplomuarve të papunë kanë qenë në marrëdhënie pune më herë. Në këtë aspekt viti 2025 shënon një rënie me 3 pikë përqindje.

Figura 28: Të diplomuarit papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=26); **2017** (N=29); **2018** (N=11); **2019** (N=24); **2020** (N=27); **2021** (N=28); **2022** (N=16); **2023** (N=13), **2023** (N=13); **2024** (N=7), **2025** (N=13).

Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën 12 kanë "shumë/jashtëzakonisht shumë" nevojë për përmirësim.

Theksi këtë vit, është tek nevoja për përmirësimin e bashkëpunimit me bizneset (33%), me një rënie me 18 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2024 (51%), këshillimi i karrierës (33%), me një rënje me 10 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2024 (43%) bashkëpunimi me zyrat e punës (29%), me një rënie me 18 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (47%), si bashkëpunimi me zyrat e punës (29%).

Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2016-2025)


	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Infrastruktura	35%	39%	19%	19%	30%	52%	49%	58%	33%	28%
Kurrikula			13%	14%	38%	44%	42%	60%	36%	26%
Tekstet dhe materialet	30%	30%	13%	23%	49%	59%	41%	56%	48%	26%

Metodat e mësimdhënies	25%	27%	13%	19%	44%	63%	52%	53%	48%	28%
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve			19%	14%	48%	63%	49%	58%	56%	31%
Praktika në shkollë	40%	39%	38%	36%	47%	58%	48%	63%	60%	26%
Praktika në biznes	35%	61%	56%	29%	54%	63%	60%	62%	62%	31%
Këshillimi i karrierës	20%	33%	38%	24%	47%	55%	58%	63%	55%	33%
Bashkëpunimi me bizneset	40%		50%	24%	53%	57%	61%	65%	55%	33%
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	35%	36%	31%	24%	53%	55%	60%	53%	54%	29%

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur "shumë/jashtëzakonisht shumë". Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=20); **2017** (N=33); **2018** (N=16); **2019** (N=21); **2020** (N=96); **2021** (N=61); **2022** (N=69); **2023** (N=52), **2024** (N=52), **2025** (N=36),

Nëse do të kishin mundësi, 91% e të diplomuarve në vitin 2025 do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe 84% të njëjtën shkollë (shiko figurën 29). Mesatarisht, nga viti 2018-2024, 85% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtën degë, dhe 86% të njëjtën shkollë.

Figura 29: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=44); **2019** (N=55); **2020** (N=96); **2021** (N=116); **2022** (N=107); **2023** (N=78), **2024** (N=74), **2025** (N=74)

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e të njëjtës degë dhe shkollë paraqitet në tabelën 13. Për vitin 2025, 100% e të diplomuarve në Teknologji Ushqimore dhe në TIK dhe 94% në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore do të zgjidhnin të njëjtën degë. Ndërkohë, 100% e të diplomuarve në Teknologji Ushqimore, 94% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, 89% e të diplomuarve në TIK, 83% e të diplomuarve në Hoteleri Turizëm dhe 71% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë. Sikurse vërehet nga tabela, të diplomuarit në Teknologji Ushqimore tregojnë nivelin më të lartë të përzgjedhjes së të njëjtës degë dhe shkollë krahasuar me drejtimet e tjera për vitin 2025 me 100%.

Mesatarisht, nga viti 2018-2025, 85% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 86% do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë. Ndërkohë, mesatarisht për vitet 2020-2025, 90% e të diplomuarve

në Hoteleri-Turizëm, do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë dhe 89% të njëjtën degë. Mesatarisht, 86% e të diplomuarve në TIK, 2018-2025, do e përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 87% të njëjtën shkollë. Ndërkohë, mesatarisht, 2021-2025, 90% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, do ta përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 75% të njëjtën shkollë.


Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2025)

		Ekonomi-Biznes	Hoteleri-Turizëm	TIK	Shërbime Sociale dhe Shëndetësore	Teknologji Ushqimore
2018	Degë	88%		82%		
	Shkollë	92%		82%		
2019	Degë	86%		94%		
	Shkollë	86%		100%		
2020	Degë	73%	91%	80%		
	Shkollë	62%	86%	74%		
2021	Degë	82%	90%	91%	67%	
	Shkollë	76%	93%	88%	56%	
2022	Degë	95%	79%	69%	80%	
	Shkollë	100%	88%	72%	90%	
2023	Degë	92%	96%	80%	73%	92%
	Shkollë	100%	91%	87%	73%	92%
2024	Degë	90%	91%	89%	60%	89%
	Shkollë	100%	100%	100%	100%	53%
2025	Degë	71%	89%	100%	94%	100%
	Shkollë	71%	83%	89%	94%	100%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2018**: N_{AZ}=9; N_{EB}=24; N_{TIK}=11; **Baza 2019**: N_{EB}=37; N_{TIK}=18; **Baza 2020**: N_{EB}=26; N_{HT}=35; N_{TIK}=35; **Baza 2021**: N_{EB}=33; N_{HT}=40; N_{TIK}=34; N_{SHSSH}=9; **Baza 2022:** N_{EB}=20; N_{HT}=48; N_{TIK}=29; N_{SHSSH}=10; **Baza 2023:** N_{EB}=13; N_{HT}=22; N_{TU}=13; N_{TIK}=15; N_{SHSSH}=15. ; **Baza 2024:** N_{EB}=10; N_{HT}=23; N_{TU}=9; N_{TIK}=17; N_{SHSSH}=15, **Baza 2025:** N_{EB}=14; N_{HT}=18; N_{TU}=7; N_{TIK}=19; N_{SHSSH}=16.

Të ndara sipas gjinisë përzgjedhja e të njëjtës degë studimi dhe shkollë jepet në figurën 30. Kështu, 81% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 88% e të diplomuarave të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Ndërkohë, 93% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 88% e të diplomuarave të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë.

Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe shkollë sipas gjinisë 2025



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: M** (N=42); **F** (N=32)

Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtejshëm (shiko tabelën 14), 43% e të diplomuarve në vitin 2025 pohojnë se kanë dëshirë të kenë gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit. Aspiratat për një gjë të tillë kanë shënuar rritje për vitin 2025 kanë shënuar një rritje me13% pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2024 (30%).

Për më tepër, 31% duan të kenë filluar biznesin e tyre, me një rritje prej 2 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (29%) si dhe 19% e të diplomuarve kanë dëshirë të jenë duke ndjekur studime të mëtejshme, duke ruajtur të njëjtën përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (19%). Ndërkohë, për vitin 2025, vetëm 7% e të diplomuarve planifikojnë të emigrojnë jashtë vendit në dy vitet e ardhshme, me një ulje me 9 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2024 (16%). Dëshira për migrim të brendshëm gjithashtu është ulur në 1%.

Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Të jem punësuar	37%	26%	27%	42%	16%	30%	23%	21%	18%	19%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	2%	12%	50%	25%	29%	35%	38%	31%	45%	43%
Të kem filluar biznesin tim	21%	18%	20%	18%	45%	28%	36%	42%	35%	31%

Të kem ndjekur studime të mëtejshme	14%	27%	23%	22%	19%	16%	13%	17%	23%	19%
Të kem emigruar jashtë vendit	8%	29%	25%	25%	23%	16%	8%	6%	3%	7%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	37%	2%	2%	2%	0%	1%	1%	0%	3%	1%
Tjetër	21%	6%	5%	0%	6%	4%	3%	5%	3%	4%

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=63); **2017** (N=66); **2018** (N=44); **2019** (N=55); **2020** (N=96); **2021** (N=116); **2022** (N=107); **2023** (N=78), **2024** (N=74), **2025** (N=74)

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e raportit të gjurmimit për shkollën "Kolin Gjoka". Për brezin 2025 janë gjurmuar të gjithë 74 të diplomuarit. Megjithatë, disa tregues mbështeten në nëngrupe të vogla dhe raporti përmban mospërputhje që kërkojnë verifikim para interpretimit.

1. Më shumë mbështetje për gjetjen e punës në profesion

Njësia e Zhvillimit të diskutojë me të diplomuarit që punojnë jashtë fushës së studimit për pengesat që kanë hasur. Me bizneset partnere të identifikohen vende praktike dhe mundësi punësimi të lidhura me profilet e shkollës.

Gjetja: Vetëm 39% e të punësuarve me përgjigje të vlefshme deklarojnë se puna lidhet me arsimin e tyre (N=44). Ndërkohë, 43% e të gjithë të diplomuarve dëshirojnë të gjejnë një punë në fushën e studimit brenda dy viteve të ardhshme.

2. Lidhje më të drejtpërdrejta me punëdhënësit

Shkolla të organizojë takime me punëdhënës, të ndajë rregullisht vende të lira pune dhe të ndjekë mundësitë e punësimit pas praktikës. Mbështetja për aplikim të shoqërohet me ndërmjetësim konkret dhe bashkëpunim me zyrën e punësimit.

Gjetja: Në 2025, 70% raportojnë se shkolla i ka mësuar të kërkojnë dhe të aplikojnë për punë, por vetëm 35% se i ka ndihmuar të vendosin kontakte me punëdhënës. Punën e parë e kanë gjetur 58% përmes lidhjeve personale, 14% përmes praktikës në biznes dhe 5% përmes qendrës së karrierës ose Njësisë së Zhvillimit (N=43).

3. Mbështetje e përshtatur për të diplomuarit pa punë

Shkolla të kontaktojë të diplomuarit pa punë dhe të identifikojë nevojat individuale për këshillim, ndërmjetësim ose trajnim plotësues. Vëmendje e veçantë t'u kushtohet vajzave dhe të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, duke dalluar kërkimin e punës nga vijimi i studimeve.

Gjetja: Pa punë janë 18% e të diplomuarve (13 persona), prej të cilëve 9 kërkojnë punë. Papunësia raportohet nga 25% e vajzave dhe 12% e djemve. Në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, 31% janë pa punë, ndërsa 44% vijojnë studimet (N=16). Këto rezultate kërkojnë trajtim sipas situatës së secilit.

4. Më shumë informacion për kushtet e punës

Në orientimin në karrierë të përfshihen sesione praktike për kuptimin e kontratës, kushteve të punës dhe mënyrave të verifikimit të sigurimeve. Të diplomuarit të orientohen drejt shërbimeve përkatëse kur kanë paqartësi.

Gjetja: Në 2025, 23% e të punësuarve me përgjigje të vlefshme raportojnë se nuk kanë kontratë pune. Përkatësisht, 40% kanë kontratë me afat të caktuar dhe 37% me afat të pacaktuar (N=43).

5. Mbështetje praktike për interesin për vetëpunësim

Të diplomuarve që shprehin interes për hapjen e një biznesi t'u ofrohet këshillim fillestar për zhvillimin e idesë, vlerësimin e tregut dhe përgatitjen e një plani të thjeshtë biznesi. Të krijohen mundësi takimi me sipërmarrës dhe shërbime mbështetëse.

Gjetja: Vetëm 4% e të diplomuarve janë të vetëpunësuar, ndërsa 31% dëshirojnë të kenë filluar biznesin e tyre brenda dy viteve të ardhshme (N=74). Ky dallim sugjeron nevojën për të kuptuar sa i konkretizuar është interesi dhe çfarë mbështetjeje kërkohet.